



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.229-2/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkritazi me kërkesën për rishqyrtim Anr.229-4/2025, të parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr.229/2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë;05.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa Anr.229-4/2025 e datës;31.01.2025, të parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin e vendimit të PZAP-it, A.nr.229/2025, të datës 30.01.2025, me të cilin i është shqiptuar dënimi më gjorbë në lartësi prej 4,000.00 (katërmijë) Euro, dhe ka detyruar Subjektin Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Paneli me Vendimin Anr.229/2025 të datës 30.01.2025, e kishte miratuar ankesën e Subjektit Politik LVV, parashtruar kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 4,000.00 (katërmijë) Euro, dhe ka detyruar Subjektin Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

PZAP-i, me datë;31.01.2025, ka pranuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Anr.229-4/2025, nga Subjekti Politik LDK, me të cilën pretendohet se mbi bazën e bashkangjitura në email (sqarimi dhe fotoja) nuk janë administruar nga PZAP. Të njëjtat dëshmojnë për reagimin e Degës së Istogut për një poster të vendosur në fshatin Banjë i cili nuk kishte asnjë përmbajtje klasike zgjedhore-sepse nuk e kishte numrin e partisë që në këto zgjedhje është 124, nuk e kishte llogon zyrtare të partisë, nuk kishte thirrje për votim dhe me këtë rast PZAP po krijon pasiguri juridike në vendimmarrje dhe precedent shumë të rrezikshëm, sepse

materialet e tilla mund të vendosin edhe persona të tjerë të pidentifikuar dhe pastaj të ankimojnë kundër nesh si subjekt, pra menaxhimi dhe administrimi i provës në këtë rast nuk ka qenë i mjaftueshëm e as bindës ligjërisht nga PZAP. Për këtë rast ka kërkuar rishqyrtim apo vlerësim të gjobës së shqiptuar, duke e përgjysmuar apo vlerësuar më ulët në raport me dënimin e shqiptuar prej 4.000 euro, sepse ka konsideruar se është shumë i lartë ose anulim të tërësishëm të vendimit.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se kërkesa për rishqyrtim dhe anulimin e vendimit Anr.229/2025 e datës; 30.01.2025, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht kërkesa Anr.229-4/2025, e datës; 31.01.2025, për rishqyrtimin e vendimit, rrjedh se Subjekti Politik LDK, ka bashkangjitur si provë Emailin e dërguar PZAP-së për vendosjen e posterëve. Mirëpo Paneli, Emailin e ofruar nga parashtruesi i kërkesës nuk e konsideroi si provë të pranueshme, sepse provat e tilla janë te paqarta dhe te pa lexueshme për te vërtetuar gjendjen reale faktik, andaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”. Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme për faktin se pretendimet e tilla nuk mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse dhe të njëjtat i refuzoi si të pabazuar.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura vendimi i kontestuar me rishikim, rezulton të jetë i pabazuar, jo i ndërtuar mbi fakte, prova dhe mbështetura në dispozitat ligjore në fuqi.

Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 118 paragrafi 4, me të cilin përcaktohet se, *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohej në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.*

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që kërkesën për rishqyrtim të refuzojë si të pabazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.229-2/2025, datë; 05.02.2025

Kryesues i Panelit
Ramush Bardiqi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*